



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2549, datë 27.03.2015

Për

Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k., kundër masës administrative të Dënimit me Gjobë.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 27.03.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimii ankimit administrativ të sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k., kundër masës administrative të Dënimit me Gjobë.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
3. Rregullore e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”;

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa me Referencë nr. 48, datë 25.2.2015, (nr. 311/4Prot. i AKEP, datë 27.2.2015), “Ankim administrativ” të sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k.;
2. Akti i Inspektimit nr. 311/1Prot, datë 19.2.2015; Gjoba nr. 18, datë 19.2.2015, Akti i bllokimit mbajtur më datë 12.2.2015, dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj praktike inspektimi;
3. Raportete Sektorit të Monitorimit, me anë të të cilave raportohet monitorimi i kryer për muajt janar, shkurt, prill, maj, qershor 2014;
4. Korrespondencanë formë elektronike e shkëmbyer mes palëve;
5. Relacionshpjegues (Relacioni);

sidhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhjen e bashkëngjitur, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I.

1. Sipërmarrësi Idea - Tel sh.p.k. me shkresën nr. 48Prot, datë 27.2.2015 “Ankim Administrativ” shpjegon se nëpërmjet njoftimit me postë është njohur me Aktin e Inspektimit nr. 311/1Prot, datë 19.2.2015 dhe Fletën e Gjobës nr. 18, datë 19.2.2015.

Idea - Tel sh.p.k., shpjegon se, ka filluar aktivitetin në fushën e komunikimeve elektronike prej vitit 1998, dhe ka vepruar në përputhje me kuadrin rregullator. Aktualisht është fokusuar në fushën e transmetimit të të dhënave, për një numër të kufizuar klientësh.

Idea - Tel sh.p.k. shpjegon se, gjatë gjithë kësaj periudhe i është nështruar një seri inspektimesh të përvitshme pas të cilave nuk janë vërejtur elemente të shkeljes së kuadrit ligjor/rregullator.

Idea - Tel shprehet se, në fillim të muajit shkurt 2015, është njohur me Udhrin e Inspektimit nr. 1398, datë 4.2.2015, nëpërmjet inspektorëve të AKEP dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në këtë proces duke caktuar z. Zamir Topçia, Drejtor Teknik për shoqërimin e grupit të inspektimit.

Idea - Tel shprehet se, grupi i inspektimit më datë 11.2.2015, pa njoftim paraprak ka telefonuar z. Topçia, dhe i ka kërkuar ta shoqëronte për inspektim në Prezë. Duke qenë se z. Topçia, ka qenë me shërbim jashtë Tirane atë ditë, i ka shpjeguar inspektorëve të AKEP, se të nesërmen e në vijim do të ishte prezent për t’i shoqëruar në çdo pikë transmetimi. Grupi inspektimit ka vijuar inspektimin pa prezencën e përfaqësuesve të Idea - Tel, për ditët në vijim.

Në paraqitjen e dytë Idea – Tel sh.p.k. i ka vënë në dispozicion grupit gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe në vijim grupi nuk është paraqitur me Aktin e Inspektimit, për njohje paraprake dhe firmosje nga Idea - Tel.

Idea - Tel shprehet se të gjitha veprimet në lidhje me këtë proces janë kryer në mënyrë të njëanshme, duke mos krijuar mundësi të shprehin mendimet dhe qëndrimet në lidhje me konstatimet e grupit të inspektimit.

2. Idea - Tel, në lidhje me Aktin e Inspektimit dhe Fletën e Gjobës, paraqet qëndrimin dhe argumentet si më poshtë:

1. Në lidhje me mosshoqërimin e grupit të inspektimit, informon se, grupit nuk i është nxjerrë asnjë pengesë për kryerjen e veprimtarisë inspektuese dhe është shprehur vullnet i plotë për bashkëpunim.
2. Në lidhje me zbatimin e Rregullores “Për publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”, Idea - Tel ofron vetëm shërbimin e linjave të transmetimit të të dhënave (shërbim intranet) për institucione publike dhe private, ku përzgjedhja e Idea - Tel si ofrues shërbimi, bëhet përmes tenderit ku specifikimet teknike dhe çmimi janë pjesë e këtij procesi. Duke qenë se, këto shërbime të ofruara nuk janë për individë ose familjarë, nuk është gjykuar se është e nevojshme faqja e internetit.
3. Sa i takon përdorimit të spektrit të radio frekuencave, Idea - Tel shprehet se, brezat për shërbimin fiks, lidhje radio pikë-pikë, për vitin 2014 zotëron Autorizim Individual për përdorim të frekuencave në 67 drejtime (67 lidhje fikse të autorizuar).
4. Për përdorimin e frekuencave për vitin 2015, Idea - Tel shprehet se me shkresë të datës 18.2.2015, ka njoftuar AKEP-in se është në proces ndryshimesh rrënjësore teknologjike, të cilat do të shoqërohen me ndryshime në brezat e frekuencave dhe teknologjive radio të përdorura.
5. Idea - Tel, shprehet se, paraqitja e disa fakteve në lidhje me përdorimin e frekuencave nga ana e tyre, përmes fotove të kullave dhe me disa matje të paqarta dhe herë herë jo në përputhje me kërkesat teknike për monitorimin e lidhjeve radio pikë-pikë janë të pamjaftueshme për të etiketuar përdorueshmërinë e frekuencave nga Idea - Tel.

3. Në lidhje me ofrimin e shërbimeve dhe organizimin e rrjetit, Idea - Tel shpjegon se, ka ndërtuar rrjetin e tij kombëtar të transmetimit të të dhënave bazuar në transmetimet pikë-pikë, mbështetur në teknologjinë Ericsson (për të cilën ka certifikatë miratimi tipi nga AKEP). Idea - Tel shpjegon se, ofron shërbim për institucione publike të një rëndësie të veçantë dhe për qëllime sigurie ka qenë i nevojshëm aplikimi i modelit 1+1 ‘standby’, veçanërisht për pjesën e rrjetit ‘backbone’. Duke dhënë shpjegimet teknike Idea - Tel shprehet se për shkak të konstuktimit të veçantë të lidhjeve fikse, të jepet përshtypja se ka pajisje transmetuese të paligjshme, por në realitet skema e funksionimit nuk ka përdorim abuziv të frekuencave.

4. Në lidhje me veprimtarinë rregullatore dhe kushtet e tregut, Idea - Tel shprehet se, ka ushtruar veprimtarinë në fushën e komunikimeve elektronike në përputhje me kuadrin ligjor/rregullator dhe ka shlyer në mënyrë të rregullt detyrimet financiare duke qenë një nga 10 pagesit më të mëdhenj në AKEP.

5. Idea - Tel shprehet se, gjatë përdorimit të frekuencave nuk ka qenë asnjëherë burim interferencash, dhe transmetimet radio nuk kanë çenuar sigurinë publike, dhe nuk kanë qenë burim rreziku për ekspozimin e publikut ndaj fushave elektromagnetike.

Idea - Tel shprehet se, inspektimi nga AKEP, çdo vit apo dy herë në vit, apo me prioritet të veçantë në fillim të vitit, të krijojnë përshtypjen se nuk kemi të bëjmë me qasje të zakonshme, për më tepër nuk duket i arsyeshëm për një operator që nuk ka krijuar probleme me konkurrencën, nuk ka sjellje abuzive/mosmarrëveshje ndaj klientëve dhe nuk ofron shërbime publike për individë apo familjarë.

Idea - Tel shprehet se, vendosja e masës së ndëshkimit me gjobë, në përfundim të inspektimit, përveç se dëmton kompaninë nga pikëpamja financiare, dëmton edhe imazhin publik si sipërmarrës në fushën e komunikimeve elektronike. Masa administrative gjobë, argumenton Idea Tel, ka kryesisht qëllimin e disiplinimit të veprimtarisë së sipërmarrësit si masë fundore, ndaj veprimeve të përsëritura, me pasoja të rënda si përdorimi pa autorizim i frekuencave me pasojë shkaktimin e interferencave të dëmshme, rrezikimi i sigurisë/shëndetit publik.

Gjoha e vënë shpjegon Idea Tel, i referohet ligjit nr. 9918, nenit 70/2, lidhur me njoftimin në AKEP për ndryshimet në frekuencat e dhëna: "*Përdoruesit e frekuencave janë të detyruar të njoftojnë AKEP-in për të gjitha ndryshimet e mundshme, të dhëna në shkronjën "a " të pikës 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga koha e ndodhjes së tyre*". Për këtë, Idea - Tel shpjegon se, ka njoftuar AKEP me shkresën e datës 18.2.2015, për ndryshime në përdorimin e frekuencave për vitin 2015, për këtë ka kërkuar mirëkuptimin e AKEP.

6. Idea - Tel në përfundim të sa më sipër, i kërkon Këshillit Drejtues të AKEP:

Pranimin e kërkesës për shfuqizim të masës administrative dënim me gjobë dënim me gjobë nr. 18, datë 19.2.2015.

II.

1. Në vijim të shqyrtimit të ankimit, në lidhje me procesin e inspektimit, vërehet se, me Urdhrit e Inspektimit nr. 1398, datë 4.2.2015, Kryetari i AKEP ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k. i regjistruar me Nr. 2012-AP-U275-8-7 në regjistrin e sipërmarrësve, me objekt inspektimi verifikimi i zbatimit të:

1. *Kushteve të autorizimit të përgjithshëm;*
2. *Rregullores për "Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike";*
3. *Rregullores për "Dhenien e Autorizimit individual për përdorimin e frekuencave";*
4. *Rregullores "Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve"*
5. *Verifikimi i pajisjeve dhe aparaturave me certifikatën e konformitetit;*
6. *Rregullores "Për treguesit e cilësisë së shërbimit",*
7. *Verifikimi i zbatimit të Rregullores për "Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet që përdoren në këto breza";*
8. *Rregullores për "Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve.*

2. Në zbatim të Urdhrit nr. 1398, datë 4.2.2015, Grupi i Inspektimit, më datë 19.2.2015, ka përpiluar aktin e inspektimit me nr. 311/1 Prot. datë 19.2.2015, ku shpjegohet se, më datë 6.2.2015, grupi i inspektimit është paraqitur në ambientet e Idea - Tel sh.p.k., duke e njoftuar paraprakisht, për kryerjen e inspektimit sipas objektit të të Urdhrit nr. 1398, datë 4.2.2015;

Nga Grupi i inspektimit, përfaqësuesit ligjor të Idea - Tel sh.p.k. z. Zamir Topçiu, iu dorëzua kopje e urdhrit të inspektimit dhe ju kërkua që grupit t'i krijoheshin kushtet e nevojshme për kryerjen e inspektimit në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, "Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative".

Gjatë inspektimit, grupi nuk u shoqërua (*për arsye të pajustificueshme*) nga z. Zamir Topçiu, për të kryer matjet në kullat ku janë implementuar antenat e Idea - Tel sh.p.k.

3. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me plotësimin e detyrimeve për zbatimin e kushteve të Autorizimit të përgjithshëm dhe rregulloreve të përmendura në objekt të inspektimit, Grupi i inspektimit ka konstatuar:

a.Për Autorizimin nr. 2012-AP-U275-8-7, Idea - Tel sh.p.k. ofron shërbimet:

A – Rrjete publike të komunikimeve elektronike/Rrjete publike tokësore fikse;

B – Shërbime publike të komunikimeve elektronike (1) shërbime të linjave me qira (2) shërbime të tjera të komunikimeve elektronike.

Sipërmarrësi Idea - Tel sh.p.k. nuk i ofron anjë lloj shërbimi të telefonisë publike fikse dhe internet përdoruesve fundorë.

b. Standardet dhe kualiteti i shërbimit (Miratimi i Tipit):

Sipërmarrësi Idea - Tel sh.p.k. disponon kopje të deklaratës së konformitetit të disa pajisjeve në përputhje me frekuencat e dhëna nga AKEP.

c. Antenat e instaluar të radiondërlidhjeve:

Në ambientet ku Idea - Tel sh.p.k. ka instaluar antenat e radiondërlidhjes, u bënë matjet në: Kalanë e Prezës, PSV 20 Durrës dhe Zvërnec, Vlorë. Këto matje janë pasqyruar në aktin e inspektimit nga të dhënat e marra nga Analizatori i spektrit dhe antena përmes fotove, pamjeve, grafikëve etj., bashkëngjitur aktit të inspektimit.

d. Në lidhje me shlyerjen e detyrimeve:

Grupi i inspektimit i kërkoi sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k, shlyerjen e faturës me nr. serial 125224252, e cila u likujdua menjëherë.

e. Në lidhje me zbatimin e rregullores mbi publikimin e informacionit mbi tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve, rezultoi se Idea - Tel sh.p.k., nuk e ka kryer publikimin e informacionit, pasi nuk ka ndërtuar akoma faqen e tij të internetit.

f. Pajisjet në brezin 7-18 GHz

Nga verikimi në vend, sipërmarrësi Idea - Tel, rezultoi se kishte pajisje të cilat punonin në brezin e frekuencave 7/18 GHz, të cilat janë pamiratuara nga AKEP. Grupi i inspektimit në zbatim të nenit 134, të ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe të nenit 16 Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, bëri bllokimin e tyre duke i inventarizuar dhe sekuestruar më pas. Këto veprime janë të pasqyruara në Aktet e bllokimit dhe të ndalimit të funksionimit të pajisjeve të mbajtura nga Grupi i inspektimit më datat 12.2.2015 dhe 18.2.2015.

4. Grupi i inspektimit, bazuar sa më lart konstatoi dhe shpjegoi, bazuar në nenin 137, të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 34, datë 23.12.2015 “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, ka arritur në përfundimin se:

Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike Idea - Tel sh.p.k., duke moszbatuar pikën 1, pika d, e nenit 70 të ligjit nr. 9918, është në shkelje të ligjit dhe rregulloreve e AKEP dhe ka kryer kundravajtje administrative sipas parashikimeve të nenit 135.

5. Grupi i inspektimit për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, i la sipërmarrësit Idea - Tel sh.p.k. këto detyra:

- Të njoftojë menjëherë në AKEP të gjitha ndryshimet e mundshme të frekuencave, brenda 30 ditëve nga ndodhja e tyre sipas neneve 70 dhe 71 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar;

- Të vërë në funksionim menjëherë faqen kombëtare të sipërmarrësit Idea-Tel sh.p.k. me domain www.ideatel.al;
- Të bëjë publikimin e informacionit për tarifatat në funksion të zbatimit të rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”
- Të ç’kyçë të gjithë sistemet që operojnë në brezat 7/18GHz, të cilat nuk janë të regjistruar në sistemin e AKEP dhe të çmontojë këto sisteme nga kullat ku janë fotografuara.

Të gjitha këto detyra sipërmarrësi Idea - Tel sh.p.k. duhet t’i zbatojë brenda datës 31.3.2015.

6. Grupi inspektimit, bazuar në nenin 137, pika 1 e paragrafit V, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, dhe nenit 35 të Rregullores nenit 35 të “Rregullores për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka vendosur: Për moszbatimin e pikës 1, pika d, e nenit 70, të vendosë gjobë në vlerën 1.000.000 (një milion) Lekë për sipërmarrësin Idea - Tel sh.p.k.

III.

Këshilli Drejtues, pas shqyrtoi pretendimet ankimese të subjektit dhe argumentet e Gr. të Inspektimit, çmonduke argumentuar se:

- Ankimi i administrativ i paraqitur me shkresën me Referencë nr. 48, datë 25.2.2015, i sipërmarrësit Idea – Tel sh.p.k. është kryer brenda afatit 10 ditor, të parashikuar nga Rregullorja nr. 34, datë 23.12.2014 dhe në përputhje me formën e kërkuar ligjore.
- Grupi i inspektimit në zbatim të parashikimeve të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2015, për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka kryer veprimet procedurale duke zhvilluar procedure inspektuese;
- Përfaqësuesit ligjor të sipërmarrësit Idea Tel, z. Zamir Topçiu, bazuar në përcaktimet e nenit 12 të Rregullores nr. 34/2014, pika 12.1 dhe 12.2e saj i është dorëzuar një kopje e Urdhërit të Inspektimit nr. 1398, datë 4.2.2015;
- Nga konstatimet në aktin e inspektimit, grupi nuk është shoqëruar nga përfaqësuesi z. Zamir Topçiu, pasi ky i fundit nuk ka ofruar bashkëpunimin gjatë procesit të inspektimit;
- Grupi i inspektimit më datë 19.2.2015 meanë të postës elektronike (*e-mail*), ka njoftuar sipërmarrësin Idea – Tel sh.p.k., në adresën info@runbox.com, për nënshkrimin e aktit të e inspektimit;
- Sa i takon pretendimeve të ankimesit Idea – Tel sh.p.k., lidhur me masën administrative gjobë si “ masë fundore” cilësuar prej tij, ndaj veprimeve të përsëritura me pasoja të rënda, pretendimit se ky sipërmarrës ka qenë i rregullt sa i takon detyrimeve rregullatore dhe se pas inspektimeve të AKEP ka rezultuar pa probleme, shpjegojmë se: nga Sektori i Monitorimit të Spektrit, jemi vënë në dijeni dhe jemi njohur për Raportet e Monitorimit të muajve janar, prill, maj 2014, depozituar në Drejtorinë e Kabinetit të AKEP.

Në këto Raporte:

- Nga matjet e kryera në Zvërnec, ka rezultuar se sipërmarrësi Idea - Tel sh.p.k. ka në përdorim 10 lidhje fikse radio, pa autorizim individual, duke paraqitur dhe

- frekuencat përkatëse. Per kete, u mor masa e sekuestrimit te 5 pajisjeve radio outdoor.
- Nga matjet e kryera ne Dajt ne muajin prill 2014, nga 20 lidhje fikse radio qe janë matur ne kullën e Idea-Tel, asnjë prej tyre nuk rezulton ne përputhje me autorizimin individual te lëshuar nga AKEP. Per kete, u mor masa e sekuestrimit te 10 pajisjeve radio outdoor.
 - Nga matjet e kryera ne Cervenake ne muajin Maj 2014, ka rezultuar se sipërmarrësi Idea-Tel ka ne përdorim 2 lidhje fikse radio pa autorizim individual, per te cilat u mor masa e sekuestrimit.
- Gjithashtu, në lidhje me rregullsinë e kryerjes së pagesave të pretenduar nga Idea-Tel sh.p.k., theksojmë siç edhe më lart u parashtrua në aktin e inspektimit (pika 3/d), subjektit i është tërhequr vëmendje, nga grupi i inspektimit dhe pasi inspektorët e AKEP kanë ndërgjegjësuar sipërmarrësin për shlyerjen e detyrimeve “në kohë” pagesat janë prej tij në një kohë të mëpasshme.
 - Pretendimi i sipërmarrësit ankimues se, ka njoftuar AKEP-in në lidhje me ndryshimet e rëndësishme në rrjet e teknologji për vitin 2015, me shkresën e datës 18.2.2015, konstatohet se ky njoftim është kryer pas daljes së Udhrut të inspektimit nr. 1398, datë 4.2.2015, si rezultat ky pretendim është i pambështetur dhe si i tillë nuk mund të merret në konsideratë për sa i takon kërkesës për shfuqizim të masës administrative “Gjobë”.

Sa më lart shqyrtuar në lidhje me rregullsinë e procedureë së inspektimit dhe ligjshmërinë e veprimeve juridike të mbajtura nga grupi i inspektimit, rezulton se,

Sipërmarrësi Idea – Tel sh.p.k. në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, neni 70, gërma d) e tij, dhe neni 71, ka përdorur pajisje të cilat operonin në frekuenca të paautorizuara nga AKEP;

Për shkeljet e tjera të ezauruara nga sipërmarrësi dhe të konstatuara nga inspektorët, grupi i inspektimit ka gjykuar lënien e detyrave konkrete, dhënien e rekomandimeve, duke caktuar afat për rregullimin e shkeljes, konform nenit 33 “Kundravajtjet administrative” Kreu V, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014.

Bazuar në pretendimet e palës, arsyetimet dhe provat e paraqitura nga grupi i inspektimit, dhe nga analiza e themeltë e çështjes objekt shqyrtimi, arsyetojmë se, vendosja e masës administrative “Gjobë” (nr. 18, datë 19.2.2015) për ligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe proceduriale të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në nenin 146/ a) të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të masës administrative Gjobë me nr. 18, datë 19.2.2015, të vendosur nga Grupi i Inspektimit dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur me shkresën me Referencë nr. 48, datë 25.2.2015, të sipërmarrësit Idea – Tel sh.p.k.
2. Përbushjen e detyrave të lëna në Aktin e Inspektimit me nr. 311/1 Prot. datë 19.2.2015, për sipërmarrësin Idea - Tel sh.p.k. brenda datës 31.3.2015.
3. Të njoftohet sipërmarrësi Idea – Tel sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

KyVendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**